

# STATUT I SHOQËRISË AKSIONARE "FK TOMORI 1923"

Sot më datë 01.08. 2011, me cilesinë e aksionarit themelues **BASHKIA BERAT**, e përfaqësuar sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak, nr. 33 të datë 26.07.2011 nga kryetari i saj, **Z.FADIL NASUFI**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 18.03.1958, lindur në Vojnik Berat dhe banues në lagjen "Donika Kastrioti" Berat, person madhor me zotësi juridike për të vepruar mbajtës i letërnjoftimit me nr.029183394 dhe nr. personal F80318065K ka hartuar statutin që vijon të Shoqërisë Aksionare me termat e mëposhtëm:

## KAPITULLI I

### FORMA LIGJORE, OBJEKTI, EMËRTIMI, SELIA, KOHËZGJATJA

#### NENI 1

##### Forma Juridike

1. Në mbështetje të vullnetit të aksionarit themelues të shprehur në aktin e themelimit si dhe në pajtim të plote me dispozitat e Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të Ligjit Nr. 9376, datë 21.04.2005 "Per Sportin", (i ndryshuar), dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që drejtojnë këtë aktivitet, themelohet Shoqëria Tregtare "FK TOMORI" SH.A e cila do të funksionojë sipas dispozitave të aktit të themelimit dhe këtij statuti.

#### NENI 2

##### Emërtimi

1. Emërtimi i shoqërisë do të jetë "FK TOMORI 1923" SH.A që do të ketë kuptimin: Shoqëria tregtare "Futboll Klub Tomori 1923" SH.A. Shoqëria do të ketë logon dhe vulën e saj.
2. Të gjitha shkresat, formularët e urdhërave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo nga zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës apo mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:
  - a) numrin unik të identifikimit;
  - b) formën ligjore të Shoqërisë, SH.A;
  - c) vëndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
  - d) të dhëna nëse Shoqëria është në likuidim.
3. Shoqëria do të ruajë emrin dhe stemën e Klubit të Futbollit TOMORI 1923 dhe asnjëherë nuk do ta ndryshojë atë. Ky emër do të mbetet i tillë dhe në

SHOQËRIË AKSIONARE

4 rastë të transferimit të titullit të aksioneve të kësaj shoqërie në persona të tretë.  
Emri dhe stema e Shoqërisë në asnjë rast nuk do të nxiret në likuidim edhe në rastë të prishjes së shoqërisë. Në një rast të tille ato kthehen në pronësi të Bashkisë Berat, e cila ka detyrimin të ruajë traditën e këtyre simboleve.

### NENI 3 Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

### NENI 4

#### 1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:

- Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit.
- Krijimi i ekipeve zinxhir për sportin e futbollit, si dhe pjesëmarrja në garat sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit.
- Futja në tregun e lojtarëve për të blerë lojtarë sipas nevojave të ekipit.
- Aktivitete të tjera në fushën e futbollit për interesa të shoqërisë.
- Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Shoqëria brënda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj.

### NENI 5

#### Zbatimi i normave dhe rregullave të organizmave kombëtare dhe ndërkombëtare të futbollit

1. Gjatë permbushjes së objektit të veprimtarisë së saj Shoqëria respekton statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e Federatës Shqiptare të Futbollit dhe të FIFA-s e UEFA-s.
2. Me qëllim pjesëmarrjen në garat sportive kombëtare dhe ndërkombëtare, Shoqëria detyrohet të plotësojë të gjitha kriteret e liçencimit të përcaktuara nga organizmat përkatës të futbollit.
3. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj vetëm pas marrjes dhe në përputhje me liçencat apo lejet përkatëse.

## NENI 6

### Vëndodhja e selisë dhe e-zyrave të përfaqësimit

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Lagjja "30 Vjetori", Stadiumi "Tomori" Berat.  
Veprimtaria e Shoqërisë në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë kryet nga degët e saj, të cilat funksionojnë në rrethe apo ndarje të tjera administrative të Republikës së Shqipërisë nën drejtimin e Administratorit të saj.
2. Shoqëria mund të çelë degë dhe zyra përfaqësimi të reja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ato hapen dhe prishen me vendim të Administratorit të Shoqërisë.

## KAPITULL II

### KAPITALI I REGJISTRUAR, AKSIONET, NDRYSHIMET E KAPITALIT

## NENI 7

### Vlera dhe pagesa e kapitalit të regjistruar

1. Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë është 2.000.000 lekë. Ai është i ndarë në 2000 (dymijë) aksione të zakonshme me vlerë nominale 1000 (njëmijë) lekë secili. Aksionet janë të nënshkruara dhe janë të numërtuara nga 1 deri në 2000 aksione.
2. Aksionet e themeluesit në kapitalin e Shoqërisë janë në përputhje me kontributin e mëposhtëm:
  - Aksionari themelues, Bashkia Berat, kontribuon në para në shumën 2.000.000 lekë dhe zotëron 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë të barabartë me 2000 aksione me vlerë 2.000.000 (dymilion) lekë.
3. Këto aksione janë shlyer tërësisht dhe shuma e derdhur nga aksionarët është depozituar në një llogari të hapur në emër të shoqërisë në Raiffeisen Banka sh.a Dega Berat dhe derdhja e tyre është evidentuar në çertifikatën e depozitimit e lëshuar nga Raiffeisen Banka sh.a Dega Berat.

## NENI 8

### Regjistri i aksioneve

1. Pronësia e aksioneve vërtetohet nga regjistrimi i tyre në emër të pronarëve në regjistrin e mbajtur për këtë qëllim nga Shoqëria sipas mënyrës së parashikuar me ligj. Me kërkesën e aksionarit Shoqëria i lëshon një vërtetim të regjistrimit të aksioneve në pronësi të tij.
2. Administratori i Shoqërisë është përgjegjës për mbajtjen e regjistrimit të aksioneve sipas ligjit.

**NENI 9**  
**Zmadhimi i kapitalit themeltar**

1. Kapitali themeltar i Shoqërisë mund të zmadhohet sipas mënyrave dhe rregullave të parashikuara në nenet 168 deri 180 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
2. Me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 176 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", zmadhimi i kapitalit të regjistruar mund të kryhet vetëm me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, e cila vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve që zotërojnë me shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote apo përfaqësuesit të tyre, të cilët marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo në mënyrë elektronike.
3. Kapitali i regjistruar nuk mund të zmadhohet nëse nuk janë shlyer ende kontributet për aksionet e nënshkrurara më parë.
4. Administratori është i detyruar të njoftojë për regjistrim, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, vendimin për zmadhimin e kapitalit.

**NENI 10**  
**Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

1. Zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë kryet vetëm me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë dhe në pajtim me dispozitat e neneve 181 deri 186 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
2. Zvogëlimi i kapitalit të regjistruar mund të behet vetëm me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, e cila vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote apo përfaqësuesit të tyre, të cilët marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo në mënyrë elektronike.
3. Zvogëlimi i kapitalit themeltar realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve. Zvogëlimi i kapitalit të regjistruar nuk mund të çënojë raportin e aksionarit para këtij zvogëlimi.
4. Kapitali i regjistruar nuk mund të zvogëlohet nën shumën minimale kërkuar nga ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**NENI 11**  
**Të drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet**

1. Çdo aksion i jep zotëruesit të tij të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet vjetore të Shoqërisë të destinuara për shpërndarje dhe në tepricën e aktivitetit të mbetur në rastin e likuidimit në përpjestim me aksionet që zotëron. Pronësia mbi aksionet i jep zotëruesit të tij edhe të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në Asambletë e Përgjithshme në kushtet e parashikuara në

ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe në statut.

2. Çdo aksion i zakonshëm i jep zotëruesit të tij të drejta vote në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni.
3. Aksionarët përgjigjen për detyrimet e Shoqërisë ndaj të tretëve dhe për humbjet e saj deri në masën e shumës nominale të aksioneve që zotëron. Çdo kërkim fondesh përtej kësaj shume është i ndaluar.
4. Kur aksionet u kalojnë aksionarëve të rinj këta ruajnë të drejtat dhe detyrimet që vijnë nga aksionet. Pronësia e një aksioni përmban automatikisht të drejtën e aderimit në statutin e Shoqërisë dhe në Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
5. Ndalohet emetimi i aksioneve, të cilat i japin zotëruesit të tyre më shumë të drejta vote, në raport me pjesën e kapitalit, që aksioni përfaqëson.

## KAPITULLI I III ORGANET E SHOQËRISË

### SEKSIONI I ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

#### NENI 12

#### Mbledhjet e Asamblesë dhe efektet detyruese të vendimeve

1. Të drejtat e aksionarëve, për çështjet e lidhura me veprimtarinë e funksionimit të Shoqërisë ushtrohen nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme. Çdo Asamble e mbledhur rregullisht përfaqëson tërësinë e aksioneve të zotëruara nga aksionari.

#### NENI 13

#### Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare;
  - b) ndryshime të statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
  - ç) emërimin e shkarkimin e Administratoreve;
  - d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të Regjistruar;
  - dh) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c", "ç" e "d" të kësaj pike;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) shpërndarjen e fitimeve vjetore;

- f) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;  
g) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;  
gj) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;  
h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;  
i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;  
j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;  
k) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit Mbikëqyrës dhe raportin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar.
3. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Aksionari i Vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga Aksionari i Vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtëme:
- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
  - b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
  - c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
  - ç) vendimet për investime;
  - d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### NENI 14

#### Organizimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori, Këshilli Mbikëqyrës, ose nga aksionarët që zotërojnë aksione që përfaqësojnë të paktën 5 përqind të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën njëherë në vit brenda 6 mujorit të parë. Ajo mbledhet në Selinë e Shoqërisë ose në çdo vënd tjetër të treguar në thirrje.
3. Kur Asambleja e mbledhur nuk mund të marre vendime për arsye se nuk është siguruar kuorumi i kërkuar, mbledhja e dytë thirret jo më vonë se një muaj nga data e thirrjes së parë në të njëjtat forma si e para. Njoftimi ose letrat e thirrjes së mbledhjes së dytë rikujtojnë datën dhe rendin e ditës.

## **NENI 15**

### **Rendi i ditës**

1. Rendi i ditës së Mbledhjes së Asamblesë që njoftohet si më sipër, duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për ndryshimin e Statutit, teksti i ndryshimeve duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.
2. Administratori duhet ti përgjigjet me shkrim, çdo kërkesë për sqarim për rendin e ditës, dërguar nga aksionarët jo më vonë se 8 ditë përpara datës së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.
3. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marë vendime, pavarësisht parregullsisë.
4. Projektrezolutat dhe dokumentet shoqëruese duhet të mbërrijnë në selinë e shoqërisë të paktën 5 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

## **NENI 16**

### **Evidenca e pjesëmarrjes, drejtimi i mbledhjes dhe procesverbalet**

1. Një Aksionar mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një Autorizimi nga një Aksionar tjetër apo nga një person i tretë.
2. Gjatë mbledhjes së Asamblesë përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesëve të tyre ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo liste nënshkruhet nga secili prej tyre.
3. Rregulloret përkatëse të mbledhjeve mund të parashikojnë se aksionarët që nuk janë të pranishëm kanë mundësinë e pjesëmarrjes në Asamble me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjete elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i aksionarëve.
4. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal i cili duhet të përmbajë:
  - datën e mbledhjes,
  - vendin e mbledhjes,
  - rendin e ditës,
  - emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit,
  - rezultatet e votimit,
  - vendimet e marra,
  - qëndrimin e kryetarit për vendimmarrjen, si dhe të aksionarëve, që janë shprehur kundër.
5. Procesverbalit i bashkëlidhen edhe lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

6. Procesverbali dhe lista e pjesëmarrësve duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
7. Jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, administratorët janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në faqen e internetit të shoqërisë.

#### **NENI 17**

#### **Kuorumi**

1. Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote.
2. Kur Asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 145 të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 të ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
3. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur në pikën 1 e 2 të këtij neni, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 18**

#### **Marrja e vendimeve**

1. Asambleja e Përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim, në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
2. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 15 të këtij statuti, Asambleja e Përgjithshme, merr vendime me shumicën e votave të aksionarëve, që marrin pjesë.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi aksionarët apo vendimet, që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj, në statut apo në vendime të tjera, kushtëzohet nga miratimi i aksionarit përkatës.

#### **NENI 19**

#### **Mënyra e votimit**

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendimet, nëpërmjet votimit të hapur.
2. Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës





Asambleja e Përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

#### NENI 20

Vënia në dispozicion të Aksionarit të dokumentave dhe informacioneve

1. Shoqëria mban dhe vë në dispozicion të Aksionarit, në kushtet dhe në afatet e parashikuara nga ligji, raportet, dokumentat dhe llogaritë vjetore që shqyrton Asambleja.
2. Me përjashtim të inventarëve dhe të ndonjë dokumenti tjetër të caktuar nga Asambleja, dokumentat që duhet t'u vihen në dispozicion Aksionarit i dërgohen këtij së bashku me njoftim-thirrjen për mbledhje.

### SEKSIONI II KËSHILLI MBIKËQYRËS

#### NENI 21

Përbërja dhe emërimi

1. Këshilli Mbikëqyrës kryen funksionin e mbikëqyrjes për të gjithë veprimtarinë e Shoqërisë.
2. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 3 anëtarë të cilët nuk mund të jenë edhe administratorë të shoqërisë.
3. Nuk mund të zgjidhen anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, Administratorët e Shoqërisë apo personat e lidhur me të në përputhje me parashikimet e pikës 3 të nenit 13 dhe 156 të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
4. Një person juridik që është aksionar i shoqërisë nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës. Ata janë individë të cilët duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga Administratori i Shoqërisë.
5. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e votave të aksionarëve që marrin pjesë.
6. Aksionarët e Shoqërisë kanë të drejtë të përzgjedhin secili nga 1 (një) anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës.
7. Anëtarët e parë të Këshillit Mbikëqyrës do të jenë tre persona si më poshtë vijon:
  - a. **Z.Kristo Sinjari**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 15.12.1948, lindur në Berat dhe banues në lagjen "Çlirim" pallati nr. 70. Berat, person madhor me zotësi juridike për të vepruar mbajtës i letërnjoftimit me nr.029242458 dhe nr. personal E81215095.
  - b. **Z.Alban Pambuku**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 25.05.1982, lindur në Berat dhe banues në lagjen "10 Korriku" Berat, person madhor me zotësi juridike për të vepruar mbajtës i letërnjoftimit me nr.025352970 dhe nr. personal I20525099J.

c. **Z.Besmir Blana**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 11.06.1985, lindur në Berat dhe banues në lagjen "Çlirim" Berat, person madhor me zotësi juridike për të vepruar mbajtës i letërnjoftimit me nr.024846834 dhe nr. personal I50611051K. të cilët kanë pranuar detyrën.

8. Kohëzgjatja e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës do të jetë tre vjet me të drejtë rizgjedhje.
9. Këshilli Mbikëqyrës nga përbërja e tij ka një kryetar dhe një zëvendëskryetar që ngarkohen me organizimin dhe zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit. Mandati si Kryetar apo zv.Kryetar si rregull zgjat për atë kohë sa këta persona kanë mandatin si anëtarë, por me vendim të Këshillit ai mund të jetë edhe për një kohë më të vogël.
10. Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit Mbikëqyrës mund të rizgjidhen.
11. Këshilli Mbikëqyrës mund të emërojë një Sekretar të zgjedhur midis anëtarëve të Këshillit ose jashtë tyre duke përcaktuar dhe kohëzgjatjen e funksionit të tij, që nuk duhet të kalojë kohëzgjatjen e funksionit të tij dhe kohëzgjatjen e vetë anëtarëve.
12. **Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë do të jetë Z.Kristo Sinjari, shtetas shqiptar, i datëlindjes 15.12.1948 lindur në Berat dhe banues në lagjen "Çlirim" pallati nr. 70 Berat, person madhor me zotësi juridike për të vepruar mbajtës i letërnjoftimit me nr.029242458 dhe nr. personal E81215095.**
13. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me Shoqërinë.

## NENI 22 Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:
- të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
  - të përgatisë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e Asamblesë;
  - të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
  - të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
  - të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
  - të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga

administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit Mbikëqyrës për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

- g) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një Ekspert Kontabël i Regjistruar, i pavarur si dhe raporti i auditimit, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.
- h) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Këshilli Mbikëqyrës duhet të thërrasë menjëherë Asamblenë e Përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të priset ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme kur:
- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.
- b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara. Pika 4 e nenit 13 të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" zbatohet në rastin kur veprimet sipas kësaj pike do të kryhen me personat e përmëndur në pikat 2 dhe 3 të nenit 13 të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- c) shoqëria, brënda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë, nga një aksionar, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Për rastet e mësipërme Asamblesë së Përgjithshme i paraqitet një raport nga një Ekspert Kontabël i Regjistruar i pavarur.

3. Detyrat e Këshillit Mbikëqyrës të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk mund t'iu delegohen Administratorëve
4. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës përgjigjen për dëmet e shkaktuara nga shkelja e detyrave të tyre dhe standardit të kujdesit, të përcaktuara në pikat 1, 2 e 3 të nenit 163 të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
5. Për shkeljet e kryera nga Administratorët, sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit 163 të ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë përgjegjës, kur nuk njoftojnë Asamblenë e Përgjithshme, edhe pse kanë dijeni për këto shkelje, apo kur nuk i kanë zbuluar ngaqë funksioni i mbikëqyrjes, sipas kërkesave të këtij ligji, nuk është kryer në mënyrë korrekte e sipas standardeve të kërkuara.

**NENI 23**  
**Skualifikimi dhe largimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës**

Detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës përfundon në rast se:


- a) personi pushon së qeni anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në bazë të dispozitave të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" duke përfshirë parashikimet e pikës 4 të nenit 167 dhe nenit 157 të këtij ligji.
- b) personi ndodhet në gjëndje paaftësie paguese;
- c) personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- d) personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
- e) *ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e këtij Këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkojë nga detyra.*

**NENI 24**  
**Mbledhjet dhe vendimet e Këshillit Mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës mblidhet me thirrjen e kryetarit, ose në rast pengimi të këtij, të zëvendëskryetarit.
2. Rregullisht dhe detyrimisht Këshilli Mbikëqyrës duhet të mblidhet një herë në tre muaj, por ai mund të mblidhet jashtë këtij rregulli sa herë e kërkon interesi i shoqërisë dhe sa herë shtrohen çështje për tu zgjidhur dhe që janë në kompetencë të Këshillit Mbikëqyrës.
3. Propozimin për thirrjen e Këshillit Mbikëqyrës mund ta bëjnë Kryetari, Zv.Kryetari, 1/3 e anëtarëve të Këshillit dhe Administratori. Këta duhet ti paraqesin me shkrim Kryetarit ose në mungesë të tij Zv.Kryetarit, kërkesën me shkaqet dhe argumentet për nevojshmërinë e mbledhjes.
4. Kryetari ose në mungesë të tij Zv.Kryetari duhet të njoftojë me shkrim brenda 5 ditëve kërkuesin nëse nuk është dakort për thirrjen, duke paraqitur shkaqet dhe argumentet.
5. Në këtë rast kërkuesi i kalon çështjen Asamblesë së Aksionarëve e cila vendos për thirrjen ose jo të Këshillit Mbikëqyrës.
6. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mbahen në selinë e shoqërisë.
7. Rendi i ditës vendoset nga Kryetari ose në mungesë të tij nga Zëvendëskryetari ose nga Administratori apo anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës që kanë kërkuar thirrjen e mbledhjes.
8. Kryetari ose në mungesë të tij Zv.Kryetari duhet të njoftojë me shkrim 15 ditë para për mbledhjen e Këshillit duke vendosur saktë rendin e ditës, orën, datën dhe vëndin e mbledhjes.
9. Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës mund t'i japë mandat një anëtar tjetër për ta përfaqësuar në një seancë të Këshillit. Çdo anëtar mund të japë vetëm një mandat për të njëjtën seancë.

## NENI 25

### Vlefshmëria e mbledhjes dhe e vendimeve

- 
1. Shqyrtimet dhe vendimet e Këshillit Mbikëqyrës janë të vlefshme kur numri i anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhje është të paktën sa tre e katërta e anëtarëve në funksion.
  2. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe të përfaqësuar. Në rast votash të barabarta ajo e kryetarit është përcaktuese.
  3. Në selinë e Shoqërisë mbahet një regjistër i pranisë i cili firmoset nga anëtarët e Këshillit pjesëmarrës në seancë.
  4. Zhvillimi i mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës regjistrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari. Procesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e marra. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.
  5. Procesverbali firmoset nga drejtuesi i mbledhjes dhe nga të gjithë anëtarët e pranishëm.

## NENI 26

### Kufizime për votimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

1. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës mbi çështje për të cilat këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, ose që mund të jetë në kundërshtim me interesat e Shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", deri në momentin kur në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që:
  - a) të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje dhe.
  - b) të autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.
2. Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm. Për një çështje të caktuar zbatohet parashikimi i pikave 2 dhe 5 të nenit 13 të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
3. Vota e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk gëzon të drejtën e votës.
4. Në rast se në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një anëtari të tij, çështja mund ti drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpara përfundimit të mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me çdo anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar.

## NENI 27

### Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës shpërblehen në bazë të skemës së propozuar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe të miratuar me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me parashikimet e pikes 1 të nenit 160 të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

## SEKSIONI III ADMINISTRATORËT

### NENI 28

#### Emërimi dhe shkarkimi

1. Administratorë të Shoqërisë mund të jenë një ose disa persona fizike. Ata emërohen nga Asambleja e Përgjithshme një afat 3 vjeçar me të drejtë rizgjedhje.
2. Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë që të shkarkojë në çdo kohë Administratorët.
3. **Administratori i parë është z.Rushan Dosti, shtetas shqiptar, i datëlindjes 15.03.1958 lindur në Skrapar dhe banues në lagjen "Çlirim", pallati nr 16, Berat, person madhor me zotësi juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër.025461405 dhe numër personal F80315092P.**
4. Mandati i Administratorit fillon më datë 01.08.2011 dhe mbaron më date 01.08.2014.

### NENI 29

#### Të drejtat dhe përgjegjësite

1. Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen:
  - të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë;
  - të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - të kujdesen për mbajtjen e saktë të dokumentave dhe librave kontabël të Shoqërisë;
  - të përgatisin dhe të nënshkruajnë pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë të cilat ja paraqesin Këshillit Mbikëqyrës për miratim së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për tu paraqitur me pas për miratim nga Asambleja e Përgjithshme;
  - të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë;
  - të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit Nr.9901 datë



14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" apo të ligjeve të tjera;

- të raportojnë përpara Këshillit Mbikqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçante, për veprimtarinë e shoqërisë;
- të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;
- Administratorët duhet të informojnë menjëherë Kryetarin e Këshillit Mbikqyrës në rastet kur:
  - Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetëme financiare rezultojnë apo parashikohet se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50% të kapitalit ose që aktivet e Shoqërisë nuk mbulojnë detyrime që janë të kërkueshme brenda 3 muajëve në vijim.
  - Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive që kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të Shoqërisë, që rezultojnë në pasyrat e fundit financiare të çertifikuara.
  - Brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozohet blerja nga një aksionar e pasurisë që ka vlerë më të lartë se 5% e aseteve të Shoqërisë.

### **NENI 30**

#### **Përfaqësimi i Shoqërisë**

1. Administratorët përfaqësojnë Shoqërinë në lidhje me të tretët. Administratorët të cilët kanë të drejtë të përfaqësojnë shoqërinë tregtare në mënyrë të përbashkët, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara.
2. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

### **NENI 31**

#### **Detyrime dhe përgjegjësi të përbashkëta të Këshillit Mbikqyrës dhe Administratorëve**

1. Administratorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës detyrohen:
  - të kryejnë detyrat e tyre, të përcaktuara në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë;
  - të ushtrojnë kompetencat, që u njihen në ligj ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve, të përcaktuara në këto dispozita;
  - të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet, për të cilat merret vendim;
  - të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Ata përgjigjen për vërtetësinë e të gjitha pasqyrave financiare, të publikimeve të detyrueshme dhe informacioneve të tjera kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë

## KAPITULLI IV EKSPERTËT KONTABËL TË REGJISTRUAR

### NENI 32

#### Emërimi dhe shpërblimi

1. Asambleja e Përgjithshme ka të drejten për të caktuar dy ose disa Ekspertë Kontabel të Regjistruar të zgjedhur nga lista e Institutit të Ekspertëve Kontabel të Autorizuar.
2. Në caktimin e Ekspertëve Kontabel të Regjistruar mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtueshmëritë e përcaktuara në rregullat e posaçme.
3. Ekspertët Kontabel të Regjistruar caktohen për një kohë që i përgjigjet një ushtrimi financiar. Ata janë të ricaktueshëm.
4. Shpërblimi i Ekspertëve Kontabel të Regjistruar caktohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe përballohet nga Shoqëria.
5. Shoqëria tregtare "FK TOMORI" SH.A do të ketë dy Ekspertë Kontabel të Regjistruar.
6. Ekspertë Kontabel të Regjistruar të shoqërisë emërohen:
  - **Z. Dhimo Dundo**, Ekspert Kontabel i Regjistruar, me licencë profesionale nr. 8 datë 11.01.2000, me adresë; Shtëpia e Ushtarakëve Berat Kat.3 Dhoma 2, Berat.
  - **Z. Afrim Suli**, Ekspert Kontabel i Regjistruar, me licencë profesionale nr. 4 datë 11.01.2000 me adresë; Rr. Sami Frashëri, Pall. TDI-Ballkan pranë Universitetit Marin Barleti, Kat 3. Ap 3, Tiranë.

### NENI 33

#### Detyrat dhe të drejtat e Ekspertëve Kontabel të Regjistruar

1. Detyrat dhe të drejtat Ekspertëve Kontabel të Regjistruar të Shoqërisë janë ato të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.
2. Asambleja e Përgjithshme mund t'u kërkojë Ekspertëve Kontabel të Regjistruar kryerjen e kontrolleve apo verifikimeve të posaçme për çështje me interes të shoqërisë. Ekspertët Kontabel të Regjistruar mund të thirren në Asamblëtë e Përgjithshme. Raportet që ata përgatitin depozitohen në selinë e shoqërisë, në afatet e parashikuara nga ligji.



**KAPITULLI V**  
**PAQYRAT FINANCIARE VJETORE, CAKTIMI I REZULTATIT**

**NENI 34**  
**Viti financiar**

1. Shoqëria përgatit çdo vit financiar Pasqyrat Financiare në pajtim me ligjin për kontabilitetin dhe Standardet Shqiptare të Raportimit Financiar.
2. Ushtrimi financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Përgjashtimisht ushtrimi i parë financiar përfshin periudhën nga data e regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit deri më 31 Dhjetor.

**NENI 35**  
**Caktimi i rezultateve**

1. Rezultati i vitit financiar nxirret dhe caktohet në pajtim me legjisllacionin në fuqi dhe mbas dhënies së raportit përfundimtar nga Ekspertët Kontabël të Regjistruar.

**NENI 36**  
**Shpërndarja e rezultateve dhe fondi rezervë**

1. Fitimet që rezultojnë nga bilanci ushtrimor do të shpërndahen sipas një vendimi përkatës të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Nga fitimet e ushtrimit pasi të jenë zbritur, kur është rasti, humbjet e mëparshme, hiqet të paktën 5% për të krijuar fondet e rezervës së domosdoshme derisa kjo rezervë arrin 1/10 e kapitalit të regjistruar.
3. Fitimi i shpërndarshëm formohet nga fitimi i ushtrimit duke hequr humbjet e mëparshme dhe shumat e hequra për rezervat dhe duke shtuar fitimet e pa shpërndara të trashëguara.
4. Megjithëkëtë, pas heqjes të shumave për t'u kaluar në rezervë në zbatim të ligjit, Asambleja e Përgjithshme, mund të heqë çdo shumë që ajo gjykon të përshtatshme për të krijuar rezerva të zakonshme ose të jashtëzakonshme ose për ta mbartur shumën në ushtrimin e ardhshëm.
5. Fitimi i shpërndashëm që mbetet shpërndahet ndërmjet aksionarëve përpjestimisht me numrin e aksioneve që i përkasin secilit.
6. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë vënien në shpërndarje të shumave që ajo heq nga rezervat që ka në dispozicion. Megjithatë dividendët caktohen në radhë të parë nga fitimet e shpërndashme të ushtrimit.
6. Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash sipas kuorumit të përcaktuar nga neni 145 i ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë

preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.


## KAPITULLI VI PRISHJA, LIKUIDIMI, KUNDËRSHTIMET

### NENI 37 Prishja, likuidimi

1. Shoqëria priset:
  - a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
  - b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
  - dh) me vendim gjykate.
2. Shoqëria likuidohet në dy mënyra, likuidim i zakonshëm dhe likuidim i thjeshtëzuar.  
Likuidimi i zakonshëm kryet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### Neni 38 Të drejtat e detyrimit e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.
4. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë të cilat miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.



5. Për mbrojtjen e kreditorëve zbatohen parashikimet e nenit 199 të ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
6. Pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve dhe shpërblimit të likuiduesit, së bashku me rimbursimin e shpenzimeve të këtij të fundit për kryerjen e detyrave, aktivet e mbetura u shpërndahen aksionarëve në përpjestim me pjesëmarrjen e tyre në kapital.
7. Pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve, likuiduesit i paraqesin Asamblesë së Përgjithshme një raport për procedurën e likuidimit, për detyrimet e shlyera dhe për shpërblimin e tij. Nëse Asambleja e Përgjithshme miraton raportin, likuiduesit lirohen nga detyra dhe përfitojnë shpërblimin e përcaktuar në raport. Nëse raporti nuk miratohet, likuiduesit mund t'i drejtohen gjykatës me kërkesën për ta shkarkuar nga detyra, si pasojë e përmbushjes në mënyrën e duhur të detyrave. Pas shkarkimit të likuiduesit nga gjykata, ai ka të drejtë të përfitojnë shpërblimin e përcaktuar në raport.
8. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.
9. Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë aksionarët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.
10. Administratorët, në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.

**Neni 39**  
**Zgjidhja e Mosmarveshjeve**

1. Të gjithë kundërshtimet gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj që lindin midis shoqërisë dhe aksionarëve ose midis vetë aksionarëve, lidhur me veprimtarinë e shoqërisë, i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

**KAPITULLI I VII**  
**DISPOZITA TË FUNDIT**

**Neni 40**

1. Nëpunësit, të zgjedhurit nga Organet drejtuese të Shoqërisë e personat që punojnë për llogari të saj, mbajnë përgjegjësi penale e civile sipas ligjit përkatës kur me dashje shkelin detyrat e ngarkuara e i shkaktojnë humbje

Shoqërisë.

#### **Neni 41**

1. Statuti hyn në fuqi mbas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
2. Gjithçka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në veçanti ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

#### **Neni 42**

1. Stauti i Shoqërisë pasi u lexua nga Aksionari i Shoqërisë u nënshkrua prej tij pa vërejtje.


Ky statut u hartua në gjashtë kopje në gjuhën shqipe.

**AKSIONARI I VETËM I SHOQËRISË "FK TOMORI 1923" SH.A**

**BASHKIA BERAT**

*E përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë*

**FADIL NASUFI**



REPubLIKA E SHQIPËRISË  
NOTERE NATASHA DERVISHI, BERAT

Nr. 2244 Rep

Nn. 1072 Jcol.

## VËRTETIM

Sot, më 19.08.2011, para meje Noteres Natasha Dervishi në Berat, u paraqit personalisht Z. Fadil Nasufi, shtetas shqiptar, i datëlindjes 18.03.1958, lindur në Vojnik Berat dhe banues në lagjen "Donika Kastrioti" Berat, person madhor me zotësi juridike për të vepruar mbajtës i letërnjoftimit me nr.029183394 dhe nr. personal F80318065K, në cilësinë e Aksionarit themelues të Shoqërisë "FK TOMORI 1923" Sh.A, madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova pasi verifikova dokumentin e tij identifikues. Ai nënshkroi lirisht para meje Noterit me vullnetin e tij të lire Statutin e shoqërisë "FK TOMORI 1923" SH.A dhe unë Noteri e vërtëtoj atë sipas ligjit.



NOTERE  
NATASHA DERVISHI